



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO			
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS			
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA			
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO			
Pranimi / Dorezimi / Puniljen / Prijetje / Received / Prilaz	09.08.2022	viti / god / year	2
Organ / Njësia / Organ / Jedinica / Org / Unit	Nr. Prot / Br. Prot / Prot No	Shtesa / Prilog / Appendix	Sasia / Kolicina / Quantity
KRIMICU	4614/2022		1/4



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.702/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca-anëtarë me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, duke vepruar sipas Aktgjykimit me numër A.nr.2736/19, të datës 29.06.2022, të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.702/2021 të datës 30.07.2021, të parashtruar nga ankuesi me adresë Komuna e Podujevës, kundër organit të punësimit Agjencia e Kosovës për Forenzikë, në çështjen juridike “Kërkesë nga Marrëdhënia e Punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 09.08.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa A.nr.702/2021 e datës 30.07.2021 e parashtruar nga ankuesi
- II. Obligohet Udhëheqësja e Njësisë së Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Kosovës për Forenzikë, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi, të nxjerrë vendim për deklarimin/rregullimin e statusit të ankuesit.
- III. Obligohet Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Kosovës për Forenzikë, që të ndërmerr veprimet e nevojshme administrative për zbatimin e këtij vendimi siç përcaktohet në pikën dy (II) të dispozitivit.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi: sipas kontratës të datës 22.07.2013 i punësuar në Agjencinë e Kosovës për Forenzikë në pozitën “Udhëheqës i divizionit për cilësi”, me datën 30.06.2021 ka pranuar e-mailin

njoftues nga Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme se, citoj *“Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik (MPB) ka shqyrtuar, verifikuar dhe vendosur statusin e të Punësuarve në Agjencinë e Kosovës, ashtu që për të gjithë të punësuarit në AFK ka përcaktuar Statusin-Nëpunës i Shërbimit Publik”*.

Ankuesi me datën 13.07.2021 ka parashtruar ankesë në Divizionin e Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme kundër njoftimit të datës 30.06.2021 lidhur me ndryshimin e statusit të themelimit të marrëdhënies së punës. Zyra e Personelit me datën 14.07.2021 i ka kthyer përgjigje ankuesit në ankesën e datës 13.07.2021 duke e udhëzuar në mjete juridike se institucioni kompetentë për trajtimin e ankesës së ankuesit është Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Ankuesi sipas udhëzimit në mjete juridike me datën 30.07.2021, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimet ankimore se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/MPB, me rastin e caktimit të statusit të zyrtarëve publik sipas Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ku për të gjithë të punësuarit në Agjencinë e Kosovës për Forenzikë ka caktuar statusin *“Nëpunës i Shërbimit Publik”*, ka vepruar në kundërshtim me legjislacionin e aplikueshëm që rregullon fushën e veprimtarisë së Agjencisë së Kosovës për Forenzikë, pasi që me Ligjin nr.04/L-064 të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë i njëjti me rastin e themelimit të punës e ka fituar statusin *“Personel i Veçantë Publik”*.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 04.08.2021, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit tek Agjencia e Kosovës për Forenzikë. Ndërsa Këshilli me datën 09.08.2021 ka pranuar nga Agjencia së Kosovës për Forenzikë, përgjigjen në kërkesë me numër protokolli: 4145/2021, se bashku me shkresat e bashkangjitura.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri me datën 08.10.2020, ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankueses, ndërsa me datën 10.09.2021, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës, e ka udhëzuar se mund të ndjek procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloj procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi ka ndjekur procedurat e tjera, duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative me datën 29.06.2022, ka nxjerrë Aktgjykimin me numër A.nr.2736/21, me ç’rast i njëjti në Këshill është pranuar me datën 14.07.2022, sipas të cilit ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit dhe ka anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 10.09.2021, duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e datës 30.07.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 3993/2021 të datës 30.07.2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-maili zyrtar i datës 30.07.2021; Kontratë pune për kohë të pacaktuar e ankuesit e datës 22.07.2013; E-maili zyrtar i datës 30.06.2021; E-maili zyrtar i datës 06.07.2021; E-maili zyrtar i datës 30.06.2021; Ankesë e ankuesit e datës 13.07.2021 drejtuar Divizionit të financave dhe shërbimeve të përgjithshme dhe personelit në Agjencinë e Kosovës për

Forenzikë; Përgjigje në ankesën e ankuesit e datës 14.07.2021 nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 09.08.2021 nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë; Rregullore Nr.06/2015 për përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të personelit të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë; E-maili zyrtar i datës 09.03.2021; E-maili zyrtar i datës 03.03.2021; Lista e të punësuarve në Agjencinë e Kosovës për Forenzikë me përshkrimin e pozitave që mbajnë; E-maili zyrtar i datës 10.06.2021; Aktgjykimin me numër A.nr.2736/2021 të datës 29.06.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës, konstatoi se është **pjesërisht e bazuar** ankesa e ankuesit **sepse:**

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë shqyrtimit të provave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankuesi në bazë të kontratës së punës të datës 22.07.2013 ka themeluar marrëdhënien e punës në Agjencinë e Kosovës për Forenzikë, ndërsa sipas listës së të punësuarve në Agjencinë e Kosovës për Forenzikë sipas përshkrimit të pozitave që mbajnë të punësuarit, i njëjti mban pozitën "Udhëheqës i divizionit për cilësi".

Lidhur me analizimin e situatës juridike për ankesën e ankuesit, Kolegji ju referua nenit 83 paragrafit 16 dhe 17 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët më të cilin është përcaktuar se: *Deklarimi apo rregullimi i statusit të punësimit të çdo personi, sipas paragrafëve 1- 8 të këtij neni, bëhet me propozim të institucionit dhe me miratimin e Njesisë përgjegjëse, brenda 2 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Procedura e deklarimit/rregullimit zhvillohet sipas Ligjit për Procedurën Administrative. 17. Ndaj vendimit për deklarimin/rregullimin e statusit të punësimit mund të paraqitet ankesë, në pajtim me ligjin, në KPMSHC, si dhe nenit 5 paragrafi 4 të Rregullores (QRK) Nr.10/2020 për Deklarimin e Statusit të Zyrtarëve Publikë është përcaktuar që: Rregullimi i statusit bëhet me vendim nga njësia përgjegjëse dhe pastaj lëshohet apo ndryshohet kontrata e punës nga punëdhënësi, rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore, Njësia e Burimeve Njerëzore të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë me rastin e verifikimit të statusit të ankuesit nga DMZP-ja, ka qenë e obliguar që lidhur me deklarimin e statusit të ankuesit të nxjerrë vendim në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.*

Kështu që, pas konstatimit se ankuesit nuk i është lëshuar akt administrativ lidhur me deklarimin/rregullimin e statusit të zyrtarit publik, dhe meqenëse e drejta e ankesës është e lejuar vetëm kundër vendimit për deklarim të statusit, Kolegji nuk është lëshuar në trajtimin e pretendimeve tjera ankimore.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.


Andaj, bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.702/2021, datë 09/08/2022.

Ardita Perçuku-Shyti


Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- ❖ Ankuesit
- ❖ Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë;
- ❖ Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë e Kosovës për Forenzikë dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK- së.

